



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

**V E N D I M**


Nr. 68, datë 27.07.2022

**PËR**  
**MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË KUSHTEVE TË LEJES SË NDËRTIMIT PËR**  
**OBJEKTIN: “GODINË POLIFUNKSIONALE “CITY HOTEL”,**  
**ME VENDNDODHJE NË RRUGËN BRIGADA VIII, BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 48 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; nenit 17, të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe VKM-së Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të zhvilluesit Z. Agim Zeqo, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë rishikimin e kushteve të lejes së ndërtimit për objektin: “Godinë polifunksionale “City Hotel”, me vendndodhje në Rrugën Brigada VIII, Bashkia Tiranë, me zhvillues Z. Agim Zeqo, miratuar me Vendimin Nr. 09, datë 23.10.2019 të Këshillit Kombëtar të Territorit.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë, miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Vendimin Nr. 09, datë 23.10.2019, zëvendësohen me Hartën e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumentin e Rregullores së Veçantë, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

**BELINDA BALLUKU**



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

**LEDIA TOTA**

